



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 14
Prishtinë, më 21 korrik 2015, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla S-II-

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCEVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Synavere Rysha, Bali Muharremaj, Adem Grabovci, Hajdar Beqa, Naim Fetahu, Duda Balje dhe Valdete Bajrami.

Mungoi: Besnik Bislimi.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Antigona Ibraj, koordinatorë e Komisionit, Mehmet Simnica, zyrtar i fushës për ekonomi, Saranda Kaçiu praktikante, Arjeta Luli, praktikante dhe Mentor Hyseni, ekspert nga GIZ-i.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Drejtori i KGJK, z. Enver Peci, Muhamet Kurtishaj – KGJK, Ilaz Papaj – KGJK, Artan Venhari – ZAP, Qëndresa Mulaj - ZAP, Emine Fazliu – ZAP, Shkëlqim Xhema – ZAP, Ilir Abazi – ZAP, Arben Selimi - ZAP, Tringa Bytyqi - GLPS, Kaltrina Ahmeti - GLPS, Florina Merovci - ZPRK, Nehat Dervishi OSBE, Bleta Gashi - Rrokum Tv, Etleva Skoja - Kosova Sot dhe Drilon Asllani – Radio- Dukagjini.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu, zv.kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 07.07.2015;
3. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të Performancës për Mirëmbajtjen dhe Riparimin e Automjeteve zyrtare. Të ftuar kryesuesi i KGJK – së, z. Enver Peci dhe drejtori i Policisë së Kosovës, z. Shpend Maxhuni.

4. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Ministrisë së Integrimeve Evropiane, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014. I ftuar ministri i MIE, z. Bekim Çollaku dhe zëvendësauditori i Përgjithshëm, z. Artan Venhari.
5. Të ndryshme.

Rend i ditës:

Zv.kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 7.07.2015

Zv.kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 07.07.2015, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të Performancës për Mirëmbajtjen dhe Riparimin e Automjeteve zyrtare

Arben Selimi - Problemet që janë vërejtur në KGJK, sa i përket mirëmbajtjes dhe riparimit të automjeteve janë, regjistri i mangët, evidentohet vetëm shuma e shpenzuar për automjete dhe jo edhe lloji dhe sasia e secilit artikull që është blerë. Në kontratat e KGJK-së janë vërejtur dallime të mëdha në mes çmimeve të artikujve të njëjtë të kontraktuar me operator ekonomik të rajoneve të ndryshme, çmime tejet të larta në raport me organizatat buxhetore tjera të audituara dhe në raport me çmimet e tregut, rrjedhimisht KGJK-ja, nuk kishte rezultuar ekonomike në procesin e mirëmbajtjes dhe riparimit të automjeteve. Pra nuk e ka arritur vlerën për para KGJK-ja nuk e ka bërë identifikimin dhe vlerësimin e nevojave bazuar në të dhënat faktike të shpenzimeve të bëra në vitet paraprake, identifikimin e nevojave e ka bërë duke u bazuar në specifikimin teknik të kontratave të mëparshme dhe asnjëherë nuk e ka marrë parasysh sasinë e artikujve që i ka blerë në kontratat paraprake, gjithashtu sasia e nevojshme asnjëherë nuk është specifikuar në kërkesën për inicim të aktivitetit të prokurimit dhe as në dosje të tenderit, pastaj artikujt të njëjtë të blerë nga organizata buxhetore të ndryshme për periudhën e njëjtë duhet të kenë çmime përafërsisht të njëjta, dallimet minimale ndërmjet artikujve janë 3%, ndërsa maksimal është 628%. KGJK-ja, ka pasur mundësi të kursej 15,618 euro ose 54% të buxhetit sikurse të kishte bërë një konsultim me organizatat e tjera buxhetore, përveç kësaj ka pasur gjithashtu edhe variacione ekstreme në mes të çmimeve të kontratave që vetë KGJK-ja i ka nënshkruar me operator ekonomik në rajone të ndryshme. Për shembull një artikull që është ekstrem i shtrenjtë janë semeringat e vegjël të cilët në Prizren kanë kushtuar 8.8 herë më shtrenjtë se sa në Pejë, ndërsa 4.4 herë më shtrenjtë se në Gjilan, nëse KGJK-ja do t'i kishte blerë këta artikuj përmes kontratës që e ka lidhur me rajonin e Gjilanit do të kishte kursyer 4,420 euro ose 77% të buxhetit që e ka shpenzuar për këtë artikull. Gjithashtu KGJK – ja ka mundur të kursej 7.530 euro ose 32% të shpenzimeve totale sikur të kishte çmime që kryesisht mund të gjinden në treg.

Enver Peci- KGJK operon me 7 gjykata themelore në tërë territorin e Kosovës. Ne me vite të tëra jemi duke punuar me automjete të dhuruara, me një amortizim shumë të madh, pjesa dërrmuese e automjeteve që ne i kemi janë ose të dhuruara nga EULEX – i ose nga donatorë të ndryshëm. Auditori ndoshta nuk e përmendi në mënyrë specifike se ku ka edhe çalime më të mëdha dhe ne menjëherë do të intervenojmë në gjykatat ku janë vërejtur këto mangësi, auditori e përmendi Prizrenin si gjykatë pak më tepër, edhe pse ne nuk jemi kompetent në kuptimin e asaj se nëse ka keqpërdorime të ndryshme. Mirëpo që me siguri organet e ndjekjes do të njoftohen edhe nëse vërtetohet mangësia subjektive atëherë me siguri që organet e ndjekjes do të marrin veprime të caktuara. Mendoj që kontratat që jepen për riparim, ndoshta ka qenë logjika që duhet me shkuar në secilin rajon për shkak të largësisë dhe mundësisë më të lehtë për me u riparuar automjetin. Mirëpo ndoshta duhet një unifikim i çmimeve, ashtu siç tha edhe auditori se ka dallime në çmime. Nëse është drejtori i logjistikës dhe drejtori i financave që drejtpërdrejt t'i përgjigjen sekretariatit të këshillit gjyqësor, këta janë mekanizmi i parë që merren me këto punë. Unë shpresoj që këta e kanë edhe në aspektin profesional dhe në mënyrë më të qartë me na sqaruar se si bëhen ato kontrata dhe pse janë bërë në shtatë rajone dhe jo në një qendër. Ne kemi probleme edhe me kryetar të gjykatave të ju them të drejtën, ata janë kryesorët që duhet me verifikuar dhe me nënshkruar në mënyrë që me njoftuar edhe sekretariatit, menjëherë ne i kemi shkruar letër kryetarëve të gjykatave për këto probleme që i ka hasur auditori dhe ne po presim që ata me na informuar se si po bëhet riparimi i automjeteve.

Muhamet Kurtishaj- Lidhur me çështjen e ngritur nga Auditori i Përgjithshëm për regjistrimin e pjesëve të ndërruara, është fakt se KGJK-ja nuk ka pasur një regjistër të pjesëve të ndërruara të secilit automjet, por shpenzimet janë llogaritur vetëm në aspektin financiar për çdo servisim të automjetit që është bërë dhe raportet dorëzohen për çdo muaj, pra për çdo muaj është njoftuar secila gjykatë sa ka pasur servisim, sa ka pasur shpenzime të karburantit, nuk është bërë regjistrimi i pjesëve për shkak se në udhëzim nuk është përcaktuar ashtu, ne kemi vepruar sipas udhëzimit të Këshillit Gjyqësor. Sa i përket çmimeve të larta në raport me çmimet e tregut, këtu kryesisht kemi probleme në rajone, për shembull në rajonin e Prishtinës ku janë shumica e automjeteve të krejt KGJK- së nuk janë potencuar vërejtje, vërejtjet janë kryesisht në rajon, ju them se dhe prej informatave që vinë nga zyra e prokurimit, kemi problem kur po hapet tenderi nëpër rajone, ka shumë raste kur i përsërisim dy-tri herë, prapë të njëjtat firma konkurrojnë, nuk ka të interesuar, kjo nuk ndodh në rajonin e Prishtinës. Në rajonin e Prishtinës kemi ofertues të mjaftueshëm, por të njëjtët operator që po e kanë kontratën gjithmonë po u jepet mundësia që të njëjtët me marr dhe pas disa anulimeve prapë nuk po mundemi me e eliminuar. Ne në bazë të raporteve vjetore që i bëjmë për shpenzime të automjeteve të vitit të kaluar, në kuadër të vlerësimeve e bëjmë edhe identifikimin për vitin e ardhshëm. Ne specifikacionin teknik kur e bëjmë për automjete, janë mbi 150 deri në 200 pjesë që ndërrohen më shpesh dhe krejt këto janë të parashikuara në dosje të tenderit, nuk kemi pasur një rast se është ndryshuar apo ndërruar diçka e nuk ka qenë në kontratë. Variacione ekstreme, është më e shpeshtë në rajonin e Prizrenit, ku për pjesë të njëjta çmimet janë më të shtrenjta me u krahasuar me rajon të Pejës apo Gjilanit. Ne nuk po kemi si të intervenojmë në këtë, e ka anuluar tre herë zyra e prokurimit tenderin për këtë

çështje dhe prapë i njëjti po konkurren edhe nuk po mundesh me ndalur dhe e ka fituar kontratën.

Artan Venhari- Arsyeja që e kemi bërë këtë auditim, është që me i vënë në dukje këto gjëra që po paraqiten dhe me i shikuar se si menaxhmentet munden me i evituar këto, u tha shumë qartë se jo regjistri i pjesëve që ndërrohen, por vetëm shuma dhe me shumë ti nuk mundësh me arritur një përfundim se çka të nevojitet. Mirëpo edhe çmimet e larta në rajone, Kosova nuk është aq e madhe që nuk mundet ndoshta me u shikuar mundësia e centralizimit ashtu që të arrihet vlera për para.

Hajdar Beqa- Po flasim këtu përveç dallimeve në çmim të artikujve të ndryshëm, janë vërejtur variacione ekstreme të çmimeve. Ne e thamë që patëm dallime ekstreme nëse e marrim Prizrenin apo Gjilanin, por e kam të paqartë sepse këtu thotë se të gjitha kontratat nënshkruhen nga i njëjti zyrtar i prokurimit, a ka pasur mundësi që kjo të centralizohet kur i njëjti zyrtar i ka udhëhequr procedurat e prokurimit, me e udhëheq një procedurë për gjitha qytetet, për arsye që mos me pasur dallime tetë herë më të shtrenjta për shembull në Prizren sesa në Pejë dhe 4.4 herë më të shtrenjta janë çmimet në Gjilan sesa në Pejë. A keni bërë një analizë të ofertave të operatorëve ekonomikë të rajoneve të ndryshme, për të parë dallimet e çmimeve për artikuj të njëjtë, vlerësimin e të gjitha ofertave e ka kryer i njëjti komision i vetëm dhe të gjitha kontratat janë nënshkruar nga i njëjti zyrtar përgjegjës i prokurimit.

Valdete Bajrami- Ju gjatë punës tuaj a keni mundur të identifikoni një arsye apo një pikë se pse nuk ka ofertues, nuk besoj se në krejt Kosovën mundet me qenë një ofertues i vetëm për çështje të caktuar. A keni mundur me vërejtur, a është çështje monopoli apo çka e ka shtyrë, se pse vetëm një ofertues çdo herë të jetë aplikant apo për një tender të caktuar dhe i vetmi ai ofertues ta fiton tenderin.

Synavere Rysha- Raporti për mirëmbajtjen dhe riparimin e automjeteve në KGJK konstaton mjaft parregullsi dhe më e keqja është se thotë se nëse kishte pasur kujdes më të madh brenda KGJK- së diku mbi 50% të buxhetit ishte kursyer, kjo është mjaft shqetësuese se diku rreth gjysma e buxhetit ka shkuar në mënyrë të parregullt, duket se dallimet ndërmjet rajoneve janë shumë të mëdha, minimalja është 3%, ndërsa maksimalja 628%, kjo është mjaft shqetësuese në një vend të vogël si Kosova. Nga vlerësimet e auditorit kuptohet që ka qenë vetëm një komision për vlerësimin e ofertave, pse nuk keni bërë ndërrimin e anëtarëve të komisionit?

Naim Fetahu – Unë do të ndalem te shpenzimet e KGJK- së bazuar në raportin e auditimit, fokusi im është te dy lloje të automjeteve, te Nissan Terrano, te këto automjete filtri i ajrit ka kushtuar te ATK-ja 15.1 euro, te Dogana e Kosovës 30 euro, kurse të KGJK- ja 63.85 euro për një filtër të ajrit, me një dallim prej 323%, kjo me të vërtetë është mjaft shqetësuese. Kurse te amortizatori i parë, dallimet në mes KGJK- së dhe organizatave të tjera buxhetore është diku për 215%. Këtu shihet që nuk ka pasur një kujdes dhe kontroll të nevojshëm. Çfarë masash mendoni të ndërmerri ju si KGJK, që të mos përsëriten prapë këto lëshime, në shpenzimin e mjeteve buxhetore?

Bali Muharremaj – Sa keni arrite që t’i zbatoni rekomandimet e auditorit gjeneral dhe nëse te KGJK- ja dhe Gjykata Themelore nuk ka drejtësi, atëherë çfarë duhet të presim nga institucionet e tjera të Kosovës?

Zv.kryetari – Në raportin e fundit të organizatës suaj, ju keni reflektuar shumë mirë me planin e veprimit, besoj që ju prapë do t’i merrni parasysh rekomandimet e auditorit. Shpresoj që kësaj radhe, do të merrni veprime konkrete sa i përket çmimeve nëpër rajone, sidomos për rajonin e Prizrenit.

Enver Peci- Unë si kryesues i KGJK- së, do të formojë një komision për të identifikuar të gjitha shkaqet e këtyre problemeve. Shpresoj që Kosova shumë shpejt do të bëjë një centralizim të prokurimit, që do të jetë një shpëtim për të gjithë ne.

Muhamet Kurtishaj- Kur të hapet tenderi për servisim dhe mirëmbajtje të automjeteve, ne zakonisht e ndajmë në loto për secilin rajon, d.m.th një procedurë e prokurimit ndahet në shtatë loto, varësisht prej rajonit ku veprojnë gjykatat. Këtu kemi të bëjmë me një raport të vitit 2011/2013 dhe jo gjithmonë ka qenë i njëjti komision për vlerësim për krejt kontratat për servisim.

Synavere Rysha- Ju thatë që nuk keni arritur me gjetur operatorë të përshtatshëm apo të përgjegjshëm, pse keni vazhduar tri herë me të njëjtin komision?

Muhamet Kurtishaj- Kur hapet tenderi dhe anulohet për shkak të mungesës së ofertave dhe nëse hapet përsëri tenderi, atëherë nuk caktohet komisioni i njëjtë, mund të jetë ndonjë anëtar, por jo përbërje e njëjtë e komisionit.

Artan Venhari- Sa i përket ofertuesve, njëra prej çështjeve që ka qenë shqetësuese, është edhe përcaktimi i kriterëve, të cilat kriterë mund të jenë diskriminuese dhe mund të pamundësojnë rritjen e gamës së ofertës. Kur i kemi vërejtur diskrepancat, në mes të çmimeve, sa i përket kriterëve nuk ka pasur kriterë diskriminuese, kurse sa i përket mungesës së ofertuesve nuk mundëm me vlerësuar pse ka ndodhë kjo. Sa i përket komisioneve ato kanë dalluar, por ajo çka ka qenë brengosë për neve është se kur i njëjti komision i ka shikuar tri lote dhe kur vërehen dallimet ndërmjet tyre.

Muhamet Kurtishaj- Përveç rajonit të Prishtinës, në të gjitha rajonet e tjera: Prizren, Pejë, Mitrovicë e Gjilan kemi probleme me ofertues, se nuk ofertojnë serviset për mirëmbajtje të automjeteve, rajonin e Prizrenit që tre herë e kemi anuluar dhe prapë i njëjti na ka ardhur sepse nuk ka ofertues. Kriteret i kemi të njëjta, nuk kemi kriterë diskriminuese, zakonisht ata që ofrojnë me çmim më të lirë ai e merr tenderin.

Valdete Bajrami- Sipas kësaj që thatë, a do të thotë kjo se është krijuar monopol i ofertuesve?

Muhamet Kurtishaj- Unë tregova se është një supozim i yni se mund të ketë marrëveshje të fshehta, fakti se gjithmonë i njëjti po oferton, nuk po ka operatorë të tjerë.

Adem Grabovci- E diskutuar se problemi është shumë i qartë, dallimet janë ekstremisht të larta, por gjithsesi unë ju përgëzoj sinqerisht për suksesin, se ka pasur ndryshime pozitive, është institucion tepër i ndjeshëm dhe prej juve ne presim shembull për mirë, por unë pajtohem me atë që tha kryetari dhe i besoj zotimit tij, se do të marrë masat e nevojshme dhe do të konstatojë edhe përgjegjësit.

Zv.kryetari- Tani kalojmë në raportin e auditorit të Pasqyrave Vjetore Financiare të vitit 2014 .

Shkëlqim Xhema- Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të KGJK- së për vitin 2014, tregon se menaxhmenti ka zbatuar kontrolle të brendshme efektive për të siguruar sistemet financiare, për vitin 2014 ka shpenzuar mbi 91% të buxhetit final, një përmirësim krahasuar me vitin 2013 për 3%. KGJK- ja ka arritur të dorëzoj me kohë të gjitha raportet të cilat janë kërkuar me ligje të aplikueshme, ka përmbushur të gjitha kërkesat e raportimit financiar, sipas kontabilitetit të parasë së gatshme dhe rregullores financiare numër 03/2013, opinionin e auditimit për KGJK- në është opinion i pamodifikuar, pra pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale. Prova efektive vërehen edhe te menaxhimi i të hyrave, menaxhimi i subvencioneve dhe transferove, në disa fusha nevojiten përforsime në kontrollin e brendshëm, kjo përfshinë menaxhimin e personelit, mbulimi i pozitave me ushtrues detyre, menaxhimin e pasurisë përkatësisht evidentimin dhe raportimin e tyre, ndërsa nga aspekti i monitorimit të kontrolleve nevojiten edhe në procesin e prokurimit, si dhe në menaxhimin e obligimeve, si çështje më të rëndësishme nga raporti i auditimit për vitin 2014 ne kemi listuar tri çështje, çështja e parë ka të bëjë me adresimin jo të kënaqshëm të vitit të kaluar edhe pse për dallim nga viti i kaluar, këtë vit ne kemi dhënë shtatë rekomandime, ndërsa vitin e kaluar kemi dhënë dymbëdhjetë rekomandime, prej këtyre dymbëdhjetë rekomandimeve, shtatë janë adresuar plotësisht, dy pjesërisht ndërsa tri nuk janë adresuar ende. KGJK- ja nuk ka aplikuar një proces efektiv për të menaxhuar rekomandimet e auditorëve të përgjithshëm bazuar në planin e përgatitjes për veprim, si rrjedhojë një pjesë e këtyre rekomandimeve kishin mbetur pa u adresuar plotësisht. Rekomandimet e pa adresuara ndërlidhen me planifikimin dhe realizimin e pagesave, procesimin e pagesave, mbulimin e pozitave me ushtrues detyre dhe menaxhimin dhe evidentimin e pasurisë. Një çështje tjetër me prioritet është edhe mbulimi i pozitave me ushtrues detyre, sipas rregullores numër 6/2012 pozita të larta menaxhuese nuk mund të plotësohen më tepër se tre muaj. KGJK- ja ka anashkaluar këtë duke mbajtur tri pozita për një periudhë më të gjatë se tre muaj, një çështje tjetër është evidentimi dhe raportimi jo i saktë i pasurisë, edhe këtu KGJK- ja nuk e ka respektuar rregulloren numër 2/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare, parregullsitë e identifikuara gjatë evidentimit dhe raportimit i kemi shpalosur në tri pika, gjashtëmbëdhjetë kompjuter në vlerë prej 9,900 euro nuk ishin evidentuar në regjistrin e pasurisë, në regjistrin e stokeve në fund të vitit janë kompjuter dhe laptop të cilët ishin futur në përdorim, ndërsa nuk ishin reflektuar te zyrtari i pasurisë për dalje dhe ngarkim të këtyre pasurive, po ashtu është vërejtë edhe një gabim gjatë regjistrimit të pasurive në regjistrin kontabël, pagesa për ndërtimin e objektit të gjykatës në Ferizaj në vlerë prej 170.000 euro ishte regjistruar gabimisht në projektin e objektit të gjykatës në Mitrovicë dega në Vushtri.

Enver Peci- Pozitat e ushtruesve të detyrës janë pozita të cilat nuk po mundim t'i parashikojmë, ndërrimet po ndodhin në mënyrë të papritur dhe ne duhet të gjejmë njerëz profesional për ato pozita. Sa i përket evidentimit të pasurisë, duhet ta kenë parasysh se KGJK-ja në mënyrë rajonale është shumë e gjerë dhe kanë mundur të ndodhin këto gabime, ndoshta janë bërë lëshime te regjistrimi i 16 kompjuterëve dhe transferimi i mjeteve te projekti i Ferizajit.

Ilaz Papaj- Jo kjo ka ndodhur te transferimi i mjeteve nga projekti i Ferizajit te projekti i Vushtrisë, ky transferim ka ndodhur në mes Ministrisë së Financave me kërkesën tonë dhe kjo është e ligjshme.

Shkëlqim Xhema- Çështja e potencuar ka të bëj me gabimin gjatë regjistrimit të pasurisë në regjistrin kontabël të pasurisë mbi 1.000 euro, vlera prej 170,000 euro në vend që t'i shtohet projektit ekzistues, këto mjete kanë kaluar te një projekt tjetër dhe kjo ka rezultuar me mbivlerësim të një projekti dhe një nënvlerësim të një projekti tjetër.

Naim Fetahu- Sa i përket krahasimit të raportit të këtij viti me raportin e vitit paraprake ka një ngritje cilësore për këtë vit. Janë dy rekomandime që janë të cekura edhe nga Zyra e Auditorit, që nuk janë zbatuar nga ana e juaj, por unë shpresoj që këto dy rekomandime do të merren parasysh dhe do të zbatohen.

Zv.kryetari- Tani është radha për shqyrtimin e Raportit të Mirëmbajtjes dhe Servisimit të Automjeteve Zyrtare të Policisë së Kosovës, është hera e dytë që KMFP i ka bërë ftesë PK- së, por ata kanë lajmëruar që nuk mund të jenë në takim as sot për shkak të angazhimeve të drejtorit të policisë.

4. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Ministrisë së Integrimeve Evropiane, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014

Zv. Kryetari- I njoftoi deputetët dhe të pranishmit se Ministri i Integrimeve Evropiane nuk do të marrë pjesë në këtë takim. Mirëpo ne, si komision, duhet te vendosim. Unë propozoj se raporti për Integritet Evropiane të diskutohet në takimin e radhës së KMFP.

Përfundim

Komisioni me shumicë votash merr vendim, që t'u jepet edhe një mundësi Policisë së Kosovës dhe Ministrisë së Integrimeve Evropiane, për raportim në Komision mbi të gjeturat e Zyrës së Auditorit.

Mbledhja përfundoi në orën 11:10.
Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zv. kryetari i Komisionit,

Ali Sadriu